

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.B nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamentit të Përgjithshëm nën numrin PP.nr.3040/2013 të datës 23.12.2013, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala dhe të akuzuarit, me datë 18.08.2016 publikisht morri dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**R.B** nga i ati I... dhe e ëma I.. e lindur ..., i lindur më datë ... në Prizren ku edhe tani jeton rruga “...” nr. ..., ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, baba i një fëmije, me numër personal ..., rom, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendjes së varfër ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

Me datë 21.10.2013 rreth orës 14:00, në Prizren në shtëpinë e tyre familjare e cila gjendet në rrugën “...”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete ia merr pasurinë e luajtshme të personit tjetër – dëmtuarës I.B nënës së tij, e shfrytëzon momentin e volitshëm mos prezencën e dëmtuarës dhe anëtarëve tjerë të familjes, hynë në dhomë dhe nga sirtari merr 220 € dhe dy byzylyk prej ari në vlerë prej 400 €, me ç’rast të dëmtuarës sjell dëm të konsiderueshëm material.

**Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 325 par.1 të KPK.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 43, 46, 50, 51, 73 dhe nenit 325 par.1 të KPK i shqipton dënimet dhe atë:

**DËNIM ME GJOBË**

Në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) të cilën shumë është e obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në afat ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 8 (tetë) ditë dënim burg duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

**DËNIM ME KUSHT**

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara I.B nga Prizreni rruga “...” nr....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtuar aktakuzë nën numrin PP.nr.3040/2013 të datës 23.12.2013, kundër të akuzuarit R.B nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtuar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 21.10.2013, në Prizrenit në shtëpinë e tyre familjare e cila gjendet në rrugën “...” i akuzuari R.B ia merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarës – nënës së tij I.B. I akuzuari e shfrytëzon momentin e volitshëm mos prezencën e nënës së tij dhe anëtarëve të familjes, hynë në dhomë dhe nga sirtari merr gjësende me vlerë dhe atë: 2 (dy) byzylyk të arit dhe para të gatshme në vlerë prej 200 €, me ç’rast të dëmtuarës shkakton dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimit vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza me ç’rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, është i martuar dhe mbajtës i familjes, ka shprehur pendim të thellë, premtori para gjykatës se në të ardhmen nuk do të ndërmerri veprime të këtilla kundërligjore, është i gjendje së varfë ekonomike, gjer më tani nuk ka kryer veprë penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i

dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarës në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1904/2013 të datës 18.08.2016**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.